

Konferenca e 35-të ndërkombëtare e komisionerëve të mbrojtjes së të dhënave dhe të privatësisë

Varshavë, Poloni

Nga data 23 deri 26 shtator 2013

Rezolutë mbi edukimin digjital për të gjithë

Mbështetur në instrumentet kryesore ndërkombëtare në fuqi, disa prej të cilave mbështeten tek të drejtat themelore të njeriut dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë:

- Deklaratën universale së të drejtave të njeriut të datës 10 dhjetor 1948 – nenet 25 dhe 26, paragrafi 3;
- Konventën evropiane të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore të datës 4 nëntor 1950 – neni 8;
- Kartën e të drejtave themelore të Bashkimit evropiane të datës 7 dhjetor 2000 – neni 241;
- Paktin ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara, në lidhje me të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore të datës 16 dhjetor 1966 – neni 17;
- Konventën 108 për mbrojtjen e personave nga përpunimi i automatizuar i të dhënave me karakter personal, të datës 28 janar 1981 dhe Protokollin shtesë të Konventës 108;
- Parimet kryesore të OCDE-së mbi mbrojtjen e privatësisë;
- Protokollin e marrëveshjes së Montevideos, mbi përjashtimin digjital të të rinjve;

Mbështetur në instrumentet ndërkombëtare që lidhen drejtpërdrejt me të drejtat e fëmijëve:

- Deklaratën e Gjenevës mbi të drejtat e fëmijëve të datës 26 shtator 1924;
- Konventën e Kombeve të Bashkuara në lidhje me të drejtat e fëmijëve, të datës 20 nëntor 1989;
- Konventën evropiane mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve, Këshilli i Evropës, nr. 160, datë 25 janar 1996;

Mbështetur në dy rezolutat e Konferencës së 30 ndërkombëtare të komisionerëve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë, në 2008-ën:

- Rezolutën mbi mbrojtjen e privatësisë në shërbimet e rrjeteve sociale;
- Rezolutën mbi privatësinë e fëmijëve në internet, e cila inkurajonte komisionerët në konceptimin e edukimit, veçanërisht të më të rinjve, me teknologjinë digjitale;

Duke caktuar rezolutën e Konferencës së 32-të ndërkombëtare të komisionerëve të mbrojtjes së të dhënave dhe të privatësisë në 2010-n, mbi mbrojtjen e privatësisë që nga etapa e konceptimit;

Duke nënvizuar Rekomandimin e Këshillit të OCDE-së, mbi mbrojtjen e fëmijëve në internet, të datës 16 shkurt 2012;

Duke iu përmbajtur Rekomandimit Rec(2006) 12, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, së datës 27 shtator 2006, drejtuar Shteteve anëtare, mbi përgjegjësimin dhe autonomizimin e fëmijëve në ambientin e ri të informacionit dhe të komunikacionit dhe Deklaratës së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, datë 20 shkurt 2008, mbi mbrojtjen e dinjitetit, sigurisë dhe privatësisë së fëmijëve në internet;

Mbështetur tek Pakti ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara në lidhje me të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore të datës 16 dhjetor 1966 – neni 13, që garanton të drejtën e edukimit për të gjithë;

Duke pasur parasysh se teknologjia digjitale bën sot pjesë në jetën tonë të përditshme, se ka pushtuar krejt fushat e ekzistencës sonë: marrëdhëniet shoqërore, familjare dhe miqësore, aktivitetet profesionale, konsumin, dëfrimet, aktivitetet kulturore, që të gjitha këto komponentë të jetës në shoqëri, kanë tashmë rezonancë në universin e teknologjisë digjitale, që kjo erë e re prek njëtrajtësisht tërësinë e popullsisë, pa dallim moshe, eksperience apo vendi;

Duke konstatuar se është e vështirë të kuptohet kompleksiteti i ambientit digjital, për shkak të shpejtësisë me të cilën zhvillohen teknologjitë e informacionit, aktorët e këtij ekosistemi dhe modeli i biznesit mbi të cilin është themeluar, përdoruesit dhe vendimmarrësit nuk kanë aftësi për të parashikuar të gjitha risqet dhe të gjitha rastet e inovacionit dhe të rritjes së ofertave nga teknologjia digjitale;

Duke qenë të ndërgjegjshëm për faktin se teknologjia digjitale ngre sfida të reja në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe të privatësisë dhe se kuadri ligjor, i vetëm, nuk mund të japë të gjitha përgjigjet dhe garancitë e kërkuara;

Të gjitha autoritetet prezente në Konferencën e 35-të ndërkombëtare të komisionerëve të mbrojtjes së të dhënave dhe të privatësisë, konsiderojnë se është e nevojshme të bëhen këto të mëposhtmet:

- **Promovimi i menjëhershëm** i një kulture të përgjithshme mbi teknologjinë digjitale, e cila do t'i lejonte gjithkujt, qoftë qytetar, konsumator apo drejtues ndërmarrjeje, të bëhet aktor aktiv, kreativ dhe kritik, i aftë për të marrë një vendim të qartë, për atë që ka të bëjë me shfrytëzimin e rasteve që lidhen me teknologjinë digjitale, duke njohur të gjitha arsyet;
- **Veprimtaria e përbashkët**, në bashkëpunim me të gjithë aktorët e përfshirë, pasi bëhet fjalë për përgjegjësi të barabartë;

Për pasojë, rezoluta fton autoritetet anëtare, duke vepruar në harmoni me të gjithë aktorët e përfshirë, që të:

- **Promovojnë** një kulturë të teknologjisë digjitale dhe të japin kontribut në formimi e publikut të ndryshëm të të gjitha moshave, me qëllim që t'u bëhet e mundur:
 - Të përftojnë aftësinë e nevojshme thelbësore, për të marrë pjesë në mënyrë efikase në ambientin digjital;
 - Të jenë aktorë të informuar dhe të përgjegjshëm të teknologjisë digjitale;
 - Të ushtrojnë në mënyrë efikase të drejtat e tyre dhe detyrime, në këtë univers;
- **Të miratojnë** një program të përbashkët të edukimit me teknologjinë digjitale, mbështetur në 5 parime kryesore dhe katër objektiva operacionale.

Parimet kryesore:

1. T'u sigurohet një mbrojtje e veçantë të miturve, në raportet e tyre me botën digjitale;
2. Të inkurajohet një trajnim në lidhje me teknologjinë digjitale, gjatë gjithë jetës;
3. Të kërkohet ekuilibri i saktë ndërmjet mundësive dhe risqeve të teknologjisë digjitale;
4. Të favorizohet trajnimi i përdoruesve kompetentë dhe të inkurajohet respektimi i përdoruesve të tjerë;
5. Të nxitet sensi kritik për sa i përket mundësive dhe risqeve të teknologjisë digjitale;

Objektivat operacionale:

1. Promovimi i edukimit për mbrojtjen e privatësisë në programet e trajnimit me kulturën digjitale;
2. Pjesëmarrja në formim e personave të ndërlidhur, duke organizuar "trajnime të trajnerëve" mbi mbrojtjen e të dhënave dhe të privatësisë, ose në bashkëpunim me ta;
3. Vlerësimi i profesionistëve të teknologjisë digjitale, duke inkurajuar veçanërisht sektorët inovatorë, sidomos ata që zbatojnë parimin e mbrojtjes së privatësisë që nga etapa e konceptimit;
4. Hartimi i rekomandimeve dhe i praktikave të mira në fushën e përdorimit të risive teknologjike drejtuar publikut të synuar (fëmijëve, prindërve, mësuesve, ndërmarrjeve, etj.).

Një grup pune do të ngrihet për vënien në jetë të këtyre objektivave operacionale

Shënim shpjegues

Autoritete të shumta të mbrojtjes së të dhënave, të cilat përfaqësojnë zonat e mëdha rajonale të botës, paraqitën eksperiencën e tyre dhe morën iniciativa të rëndësishme gjatë viteve të fundit, në fushën e ndërgjegjësimit të fëmijëve, të rinjve dhe të mjediseve të edukimit, mbi mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë.

Qëllimi i kësaj rezolute është t'i japë vazhdimësi rezolutës së Konferencës së 30-të të komisionerëve për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë dhe të shkojë më tej. Propozimet konkrete që janë shprehur, synojnë kështu të promovojnë një kulturë të përgjithshme digjitale dhe të trajtojnë publikun e ndryshëm, të të gjitha moshave. Bëhet fjalë për t'i mundësuar çdo qytetari që të jetë aktor i digjitalizimit në tërësi, i informuar dhe i përgjegjshëm, që të jetë i aftë të ushtrojë në mënyrë të efektshme të drejtat e tij dhe detyrimet në këtë univers. Na duhet pra të veprojmë tani, në shkallë më të gjerë dhe të prekim publikun i cili është në fokus.

Autoritetet do të mund të komunikojnë me qeveritë përkatëse, me qëllim parandalimin e aksioneve me përmasa të mëdha, qofshin të rendit ligjor apo të kryera në partneritet me të gjithë aktorët e fushës, përfshirë shoqërinë civile, në planin ndërkombëtar gjithashtu.

Autoritetet marrin përsipër të marrin masa afatgjata dhe të bëjnë bilanc periodik të aksioneve të kryera, me qëllim garantimin e zbatimit të rekomandimeve që përmban kjo rezolutë.